



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
AGJENCIA ZA SPREÇAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



# METODOLOGJIA PËR VLERËSIM TË RREZIKUT TË KORRUPSIONIT

Maj 2026





# Përmbajtja

<b>I. QËLLIMI DHE BAZA LIGJORE .....</b>	<b>4</b>
1. Qëllimi i metodologjisë.....	4
2. Baza ligjore për përgatitjen e metodologjisë për vlerësim të rreziqeve të korrupsionit.....	5
3. Fushëveprimi.....	5
4. Përkufizimet .....	6
<b>II. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË RREZIQEVE TË KORRUPCIONIT .....</b>	<b>8</b>
1. Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit (VRRK).....	8
1.1 FAZA E PARË: Përzgjedhja e fushës apo sektorit për zbatimin e VRRK .....	9
1.1.1 Kriteret për përzgjedhjen e fushës apo sektorit.....	9
1.1.2 Përzgjedhja e institucioneve publike nga fusha apo sektori i përzgjedhur ....	11
1.1.3 Komunikimi dhe përfshirja formale e institucioneve .....	12
1.2 FAZA E DYTË: Identifikimi i rreziqeve të korrupsionit në fushën apo sektorin e përzgjedhur .....	13
1.2.1 Procedurat e identifikimit të rreziqeve.....	13
1.2.2 Identifikimi i rrezikut.....	17
1.3 FAZA E TRETË: Vlerësimi i rrezikut dhe prioritizimi.....	18
1.3.1 Indikatorët për vlerësimin e rrezikut.....	18
1.3.2 Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit .....	19
1.4 FAZA E KATËRT: Përgatitja e raportit.....	23
<b>III. Aneksi 1.....</b>	<b>25</b>

# QËLLIMI DHE BAZA LIGJORE

## 1. Qëllimi i metodologjisë

Metodologjia për Vlerësimin e rrezikut të korrupsionit (Metodologjia) ka për qëllim të ofrojë një qasje të strukturuar dhe sistematike për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit dhe probabilitetin e shfaqjes së tyre, si dhe ndikimin e tyre nëse ndodhin.

Metodologjia përbën një qasje sistematike dhe grup të teknikave që përdoren për të identifikuar, analizuar dhe vlerësuar mundësinë dhe ndikimin e mundshëm të rreziqeve të korrupsionit brenda një organizate, sektori ose konteksti të caktuar. Metodologjia përfshin ekzaminimin e strukturuar të faktorëve të ndryshëm, mangësive dhe treguesve që mund të kontribuojnë në praktikën e korrupsionit dhe shkeljeve ligjore, me qëllim të kuptimit të rreziqeve dhe planifikimit të masave parandaluese.

## 2. Baza ligjore për përgatitjen e metodologjisë për vlerësim të rreziqeve të korrupsionit

Baza ligjore për përgatitjen dhe miratimin e kësaj metodologjie është përcaktuar në nenin 26, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalim të Korrupsionit të Kosovës<sup>1</sup>. Metodologjia miratohet nga Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (Agjencia) dhe do të jetë e aplikueshme nga publikimi i saj.

Neni 5, paragrafi 1, pika 1.2.5, dhe neni 26 i Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalim të Korrupsionit të Kosovës i ka dhënë kompetencë të plotë Agjencisë që të bëjë zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm.

Vlerësimi i rrezikut mund të bëhet në fushat apo sektorët që konsiderohen të jenë veçanërisht të ekspozuar ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe në fusha apo sektorë, të sugjeruar nga organizatat publike, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara me këtë metodologji.

## 3. Fushëveprimi

Kjo metodologji është e zbatueshme në ushtrimin e funksionit të Agjencisë në vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm të cilat do të vlerësohen me prioritet mbi bazën e kësaj metodologjie. Agjencia është përgjegjëse për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit gjatë gjithë fazave të parapara me këtë metodologji. Të gjitha institucionet dhe grupet e interesit janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe ofrojnë ndihmën e tyre në procesin e vlerësimit të rrezikut. Ligji Nr. 08/L-017 i lartcekur nuk përcakton ndonjë mekanizëm përcjellës që do të kërkonte nga organizatat dhe institucionet e përfshira në VRRK të veprojnë sipas gjetjeve të Agjencisë në procesin e VRRK-së, megjithatë sipas dispozitës së nenit 25, paragrafi 7, të këtij ligji, Agjencia monitoron zbatimin e planeve të integritetit dhe jep rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e planeve të integritetit dhe zbatimin e tyre në institucion, kështu që rekomandimet dhe rezultatet e procesit të VRRK-së mund të përfshihen në planet e integritetit të institucioneve përkatëse sektoriale, si një mekanizëm përcjellës. Gjithashtu, sipas dispozitës së nenit 27 të këtij ligji, gjetjet mbi zbrazëtitrat e caktuara ligjore mund të përdoren nga Agjencia për vlerësimin e rreziqeve të legjisllacionit të asaj kornize kundër korrupsionit. Po ashtu, rezultatet e procesit të VRRK-së mund të përfshihen edhe gjatë hartimit dhe miratimit të Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, me pjesëmarrjen dhe ndihmën profesionale të Agjencisë që i ofrohet Qeverisë në procesin e hartimit.

---

<sup>1</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60591>

## 4. Përkufizimet

Për qëllime të kësaj metodologjie përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:



**Vlerësimi i Rrezikut të Korrupsionit** - është një proces i strukturuar dhe i bazuar në dokumentacion dhe informacione zyrtare, i cili përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar dhe priorizuar rreziqet e korrupsionit brenda sektorëve të caktuar që përfshijnë organe të sektorit publik dhe entitete që ushtrojnë autoritet publik ose funksione publike të deleguara, përmes shqyrtimit të funksioneve, procedurave, proceseve të vendimmarrjes dhe mekanizmave të kontrollit, si dhe përmes hartimit të masave proporcionale të parandalimit, kontrollit dhe zbutjes së rrezikut<sup>2</sup>.



**Korrupsion** – përfshin jo vetëm veprat penale të ndërlidhura me çështje korruptive dhe ekonomike, por edhe situata apo forma të tjera të sjelljes dhe praktikave që, në mënyrë të dokumentueshme ose të matshme, mund të krijojnë kushte për keqpërdorim të funksioneve publike, burimeve apo proceseve të vendimmarrjes, siç janë konfliktet e interesit të padeklaruara ose të patrajtuara, ndikimi i padrejtë, favorizimi, manipulimi procedural, si dhe praktika të tjera që nuk janë deklaruar, trajtuar apo adresuar sipas procedurave përkatëse dhe që cenojnë integritetin, transparencën, llogaridhënien dhe paanshmërinë.



**Organizatë Publike** - nënkupton institucionet publike qendrore dhe lokale dhe ndërmarrjet publike.



**Organizata që sugjerojnë fusha dhe sektor për VRRK** - nënkupton organizata publike, organizatat jo qeveritare dhe ndërqeveritare.

<sup>2</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60591>



**Rrezik** - mundësi e ndodhjes së ngjarjes me ndikim negativ në arritje të objektivave të organizatës publike të fushës apo sektorit të caktuar.



**Faktor rreziku** - çdo atribut, karakteristikë ose ekspozim i një individi, institucioni ose procesi që rrit gjasat për sjellje korruptive apo shkelje të tjera ligjore, që mund të ketë efekte negative në objektivat dhe qëllimet e një organizate publike të fushës apo sektorit të caktuar.



**Grup interesi** - një grup interesi duhet të kuptohet si palë e interesit që ndërvepron me institucionin e përzgjedhur, ndikohet nga vendimet e tij apo ushtron funksion rregullator, përfaqësues apo mbikëqyrës relevant për fushën apo sektorin nën vlerësim. Kjo mund të përfshijë entitete të rregulluara, oda të profesionistëve të licencuar, përdorues të shërbimeve, organizata të shoqërisë civile, asociacione biznesi, oda, sindikata apo aktorë të tjerë relevantë, varësisht nga fusha apo sektori përkatës.



**Fusha** – nënkupton veprimtari funksionale, procese, politika publike ose tema horizontale, që mund të shtrihen në më shumë se një institucion apo sektor. Fusha nuk kufizohet domosdoshmërisht në një institucion të vetëm, por në një aktivitet ku mund të paraqitet korrupsioni (p.sh. prokurimi publik, menaxhimi i pasurisë publike, punësimi dhe rekrutimi në sektorin publik, etj.).



**Sektori** – nënkupton degë të administratës publike, ekonomi apo shërbime publike, ku veprojnë institucione të caktuara. Sektori ka fokusin në sistem institucional ose industri (p.sh. sektori i shëndetësisë, sektori i arsimit, sektori i energjisë, etj.).

# II. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË RREZIQEVE TË KORRUPSIONIT

## 1. Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit (VRRK)

Procesi i vlerësimit të rrezikut të korrupsionit zhvillohet përmes një qasjeje të strukturuar dhe të ndarë në faza të qarta. Secila fazë ka qëllim të veçantë dhe lidhet me fazën pasuese, duke siguruar që përzgjedhja e fushës apo sektorit, identifikimi i rreziqeve, vlerësimi i tyre dhe përgatitja e raportit të bëhen në mënyrë të organizuar, të dokumentuar dhe të krahasueshme.

Fazat e VRRK janë:

- 1 FAZA E PARË** Përzgjedhja e fushës apo sektorit për zbatimin e VRRK
- 2 FAZA E DYTË** Identifikimi i rreziqeve të korrupsionit në fushën apo sektorin e përzgjedhur
- 3 FAZA E TRETË** Vlerësimi i rrezikut dhe prioritizimi
- 4 FAZA E KATËRT** Përgatitja e raportit të VRRK

## FAZA E PARË

### 1.1 Përzgjedhja e fushës apo sektorit për zbatimin e VRRK

Në fund të vitit kalendarik apo në planin e saj të performancës për vitin vijues Agjencia mund të përzgjedhë një apo më shumë fusha apo sektorë që do të jenë objekt i vlerësimit të rrezikut të korrupsionit gjatë atij viti. Përzgjedhja bëhet mbi bazën e një analize paraprake të faktorëve relevantë të rrezikut, me qëllim që vlerësimi të jetë i përqendruar, i arsyetuar dhe efektiv.

Për këtë qëllim, Agjencia analizon faktorë të tillë si rëndësia e fushës apo sektorit, niveli i ekspozimit ndaj rrezikut të korrupsionit, ndikimi i mundshëm në interesin publik, vëllimi i shërbimeve apo vendimmarrjeve që prekin qytetarët dhe bizneset, gjetjet nga raportet e mëparshme, informacionet nga institucionet mbikëqyrëse, si dhe burimet dhe kapacitetet në dispozicion për realizimin e vlerësimit.

Përzgjedhja e fushave apo sektorëve dokumentohet në planin vjetor të punës për VRRK-në. Ky plan hartohet duke marrë parasysh burimet e disponueshme dhe nevojën për të siguruar që vlerësimet të kenë ndikim praktik në parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve të korrupsionit.

#### 1.1.1 Kriteret për përzgjedhjen e fushës apo sektorit

Duke marrë parasysh diversitetin, numrin dhe dallimet funksionale të institucioneve brenda fushës apo sektorit publik, Agjencia do të prioritzojë fushat apo sektorët dhe institucionet publike për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit bazuar në një grup të strukturuar kriteresh përzgjedhjeje të bazuara në rrezik.

Përzgjedhja do të fokusohet në fusha apo sektorë që bien nën një ose më shumë nga kriteret në vijim:

### **Kriteri statistikor dhe i ceneshmërisë**

Ky kriter vlerëson nivelin e ekspozimit ndaj rreziqeve të korrupsionit bazuar në indikatorë të disponueshëm, përfshirë por pa u kufizuar në:

- të dhënat e bazuara në perceptim;
- rastet e dokumentuara të korrupsionit;
- gjetjet e auditimit;
- ankesat nga qytetarët, bizneset apo përfaqësuesit e grupeve të interesit;
- të dhënat rreth rasteve disiplinore;
- raportet e OJQ dhe mediave;
- sinjalet tjera objektive të parregullsive.

### **Kriteri i kompleksitetit strukturor dhe rregullator**

Ky kriter vlerëson fushat apo sektorët e karakterizuar nga korniza rregullatore komplekse, numër i madh aktorësh, përgjegjësi të fragmentuara apo procese teknikisht komplekse. Vëmendje e veçantë u kushtohet fushave apo sektorëve që përfshijnë ndërmjetës të shumtë, zinxhirë nënkontraktimi apo procese vendimmarrjeje shumë të specializuara, të cilat mund të rrisin rrezikun e praktikave jo transparente apo jo të hapura.

### **Kriteri i kompetencave diskrecionale dhe vendimmarrjes me ndikim të lartë**

Ky kriter vlerëson shkallën në të cilën zyrtarët ushtrojnë diskrecion që ndikon në të drejta, detyrime apo interesa ekonomike. Vëmendje e veçantë u kushtohet fushave apo sektorëve që përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- lëshimin e licencave, lejeve, certifikimeve, pëlqimeve;
- inspektime dhe vendime rreth pajtueshmërisë;
- instrumente subvencionuese, donacione dhe grante;
- sanksione dhe masa zbatuese;
- alokim të përfitimeve, subvencioneve apo burimeve publike;
- procedura aprovimi apo autorizimi.

## **Kriteri i ndërveprimit me qytetarë, biznese apo përdorues të shërbimeve**

Ky kriter vlerëson jo vetëm ekzistencën e kontaktit të drejtpërdrejtë, por edhe, pa u kufizuar:

- shpeshhtësinë e ndërveprimit;
- nivelin e varësisë së qytetarëve apo bizneseve nga shërbimi;
- urgjencën, ndjeshmërinë apo natyrën thelbësore të shërbimit të ofruar, etj.

## **Kriteri i shërbimeve financiare (subvencione dhe instrumente të tjera të mbështetjes financiare)**

Gjatë aplikimit të këtij kriteri, Agjencia do të marrë parasysh kriteret si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

- vëllimin dhe shpeshhtësinë e transfereve financiare përfshirë kontratat e prokurimit publik, subvencioneve, granteve, donacioneve apo instrumente tjera financiare;
- nivelin e diskrecionit në përcaktimin e përfitueshmërisë apo aprovimin e pagesave;
- qartësinë dhe transparencën e kriterëve të përzgjedhjes;
- ekzistencën e mekanizmave të verifikimit dhe kontrollit;
- rrezikun e ndikimit politik apo të jashtëm në procesin e alokimit;
- kompleksitetin e procedurave të aplikimit, vlerësimit dhe pagesës;
- shpenzimet buxhetore në raport me buxhetin e alokuar në të gjitha vijat buxhetore.

## **1.1.2 Përzgjedhja e institucioneve publike nga fusha apo sektori i përzgjedhur**

Gjatë përzgjedhjes së institucioneve nga fusha apo sektori që i nënshtrohet vlerësimit të rrezikut të korrupsionit, Agjencia aplikon një qasje përfaqësuese dhe të orientuar në rrezik. Kur sektori përmban numër të kufizuar institucionesh, do të përfshihen të gjitha institucionet. Në fusha apo sektorë më të mëdhenj, Agjencia përzgjedh një mostër përfaqësuese, duke i dhënë prioritet institucioneve që:

- menaxhojnë fonde apo asete publike të konsiderueshme;
- ushtrojnë kompetenca diskrecionale në vendimmarrje (si lëshimi i licencave, inspektimet apo ndarja e përfitimeve);
- kanë ndërveprim të shpeshtë apo me ndikim të lartë me qytetarë apo biznese; ose
- paraqesin indikatorë të tjerë relevantë të rrezikut bazuar në të dhënat e disponueshme.

Përzgjedhja siguron edhe përfaqësim në nivele të ndryshme të madhësisë, mbulimit gjeografik dhe hierarkisë institucionale brenda fushës apo sektorit.

Agjencia aprovon dhe dokumenton listën përfundimtare të institucioneve dhe grupeve të interesit që do të përfshihen në VRRK, duke përfshirë një arsyetim të shkurtër të qasjes së përzgjedhjes së përdorur.

### 1.1.3 Komunikimi dhe përfshirja formale e institucioneve

Pas përzgjedhjes paraprake të institucioneve brenda fushës apo sektorit të zgjedhur, Agjencia komunikon formalisht me institucionet përkatëse për t'i informuar ato mbi vlerësimin e planifikuar të rrezikut të korrupsionit dhe nivelin e pritshëm të bashkëpunimit.

Agjencia i jep secilit institucion:

- një njoftim se është identifikuar për përfshirje në VRRK;
- një shpjegim të shkurtër mbi qëllimin, fushëveprimin dhe afatet kohore të vlerësimit;
- një përshkrim të përgjegjësive të pritshme, përfshirë pjesëmarrjen në grupe punuese, ofrimin e të dhënave dhe caktimin e personave kontaktues.

Secilit institucion do t'i kërkohet të konfirmojë gatishmërinë për të bashkëpunuar në procesin e VRRK-së dhe të caktojë zyrtarët përgjegjës që do të marrin pjesë në vlerësim.

Bazuar në përgjigjet e pranuar, Agjencia shqyrton nivelin e përkushtimit institucional dhe, kur është e arsyetuar, mund të përshtatë përbërjen e përfaqësimit të institucioneve në grupin punues. Pas këtij hapi, Agjencia nxjerr një vendim formal për aprovimin e listës përfundimtare të institucioneve dhe grupeve të interesit që do të përfshihen në VRRK për fushën apo sektorin e përzgjedhur.

Vendimi përfshin:

- listën e institucioneve pjesëmarrëse;
- fushëveprimin e vlerësimit; dhe
- afatin bazik kohor për zbatim.

Ky vendim shërben si bazë formale për themelimin e grupeve punuese dhe fillimin e procesit të VRRK-së.

## FAZA E DYTË

# 1.2 Identifikimi i rreziqeve të korrupsionit në fushën apo sektorin e përzgjedhur

## 1.2.1 Procedurat e identifikimit të rreziqeve

Identifikimi i rreziqeve të korrupsionit do të bëhet përmes mbledhjes dhe analizimit të informacionit dhe dokumentacionit që mbulon fushën apo sektorin dhe mundëson identifikimin e rreziqeve të mundshme të korrupsionit që mund të paraqiten brenda fushës apo sektorit:

- analizë e burimeve ligjore;
- raporte të auditimit;
- analizë e statistikave të fushës apo sektorit;
- raste të mëparshme të korrupsionit;
- intervista dhe anketa me grupet e interesit.

Gjatë kësaj faze do të identifikohen sistematikisht rreziqet e korrupsionit brenda fushës apo sektorit të përzgjedhur, duke përdorur metodat e mësipërme dhe duke i analizuar të gjithë faktorët e rrezikut të korrupsionit të cilët trajtohen në vijim.

### Faktorët e rrezikut për korrupsion

Pas përzgjedhjes së fushës apo sektorit, Agjencia do të identifikojë kërcënimet (rreziqet) e korrupsionit në institucionet publike të fushës apo sektorit të përzgjedhur dhe faktorët që i shkaktojnë këto rreziqe. Ekzistojnë disa kategori të faktorëve të rrezikut:

### Korniza normative (ligje dhe procedura)

Kjo kategori përfshinë analizën e kornizës ligjore dhe procedurale që rregullon fushën apo sektorin. Objektivi është të identifikohen dispozita të paqarta, diskrecion i tepruar, zbrazëtira procedurale apo mospërputhje ndërmjet rregullave formale dhe praktikës reale.

Analiza ndër të tjera mund të mbulojë:

- ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme;
- akte rregullatore specifike për fushën apo sektorin;
- rregulloret e brendshme të institucioneve;
- procedurat standarde operative (PSO);
- memorandume mirëkuptimi;
- udhëzime të brendshme;
- lista kontrolluese dhe udhëzime operative.

Vëmendje e veçantë mund t'u kushtohet, por pa u kufizuar në to, edhe:

- fushave ku vendimet merren pa kritere të qarta;
- procedurave që nuk kanë afate kohore apo kërkesa dokumentimi;
- dispozitave ligjore të mbivendosura apo kontradiktore;
- hapave në proces që varen nga diskrecioni i një zyrtari të vetëm;
- mospërputhjeve ndërmjet procedurave formale dhe praktikës reale.

Rregullat e brendshme dhe udhëzimet operative shpesh zbulojnë dobësi praktike, praktika informale apo hapësira diskrecionale që nuk janë të dukshme në nivelin e legjislacionit primar.

### **Gjetjet e kontrollit (auditime dhe inspektime)**

Kjo kategori përfshin gjetjet nga mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të mbikëqyrjes. Këto burime ofrojnë informacion objektiv mbi dobësitë në menaxhimin financiar, pajtueshmërinë dhe kontrollin e brendshëm.

Analiza ndër të tjera mund të përfshijë:

- raportet e auditimit të jashtëm;
- gjetjet e auditimit të brendshëm;
- raportet e inspektimit;
- raportet e organeve mbikëqyrëse;
- vlerësime të tjera të kontrollit të brendshëm.

Grupi punues mund të identifikojë ndër të tjera:

- parregullsi të përsëritura apo sistemike;
- rekomandime që nuk janë zbatuar;
- fusha ku kontrollet janë të dobëta apo mungojnë;
- procese ku mosrespektimi është i shpeshtë.

Gjetjet e auditimit dhe inspektimit shpesh nxjerrin në pah cenueshmëri konkrete që mund të mos jenë të dukshme vetëm përmes analizës ligjore.

## **Të dhënat operative (statistika dhe indikatorë të performancës)**

Kjo kategori përfshin të dhëna statistikore dhe administrative që pasqyrojnë mënyrën si funksionon fusha apo sektori në praktikë. Këto të dhëna mund të zbulojnë anomali, modele apo mospërputhje që mund të tregojnë rreziqe të korrupsionit.

Analiza ndër të tjera mund të përfshijë:

- statistika sektoriale apo të fushës;
- indikatorë të performancës;
- të dhëna administrative dhe operative;
- ankesa dhe informacione nga sinjalizuesit, përfshirë:
  - ankesa formale;
  - raportime përmes linjave telefonike;
  - raporte të integritetit.

Grupi punues mund të ekzaminojë ndër të tjera:

- variacione të pazakonta në vendime apo rezultate të punës;
- vonesa apo refuzime të pashpjeguara;
- përqendrimin e vendimeve në njësi apo zyrtarë të caktuar;
- ankesa të përsëritura lidhur me procese apo shërbime specifike.

Të dhënat nga ankesat dhe sinjalizimet shpesh shërbejnë si sinjale të hershme paralajmëruese për probleme sistemike apo parregullsi brenda fushës apo sektorit.

## **Rastet apo Incidentet faktike**

Kjo kategori përfshin raste apo incidente të dokumentuara të korrupsionit apo sjelljeve të tjera të ndërlidhura me shkelje. Objektivi është të identifikohen skema tipike të korrupsionit, modele dhe cenueshmëri që tashmë janë materializuar.

Analiza ndër të tjera mund të përfshijë:

- raste penale të lidhura me korrupsionin;
- procedura disiplinore;
- sanksione administrative;
- shkelje të tjera të dokumentuara brenda fushës apo sektorit.

Grupi punues, pa u kufizuar, mund të:

- identifikojë llojin e sjelljes së kundërligjshme;
- përcaktojë procesin apo vendimin ku ka ndodhur shkelja;
- vlerësojë dëmin apo ndikimin e shkaktuar;
- shqyrtojë mënyrën si është zbuluar dhe adresuar rasti.

Rastet apo incidentet e mëparshme ofrojnë shembuj konkretë si materializohen në praktikë rreziqet e korrupsionit dhe duhet të përdoren për të identifikuar rreziqe të ngjashme potenciale.

### **Perceptimet dhe përvoja praktike (intervista dhe anketa)**

Kjo kategori përfshin informacion cilësor të marrë nga palë me përvojë praktike në fushë apo sektor. Ajo ndihmon në identifikimin e rreziqeve që mund të mos pasqyrohen në dokumente formale apo statistika.

Informacioni mund të mblidhet, pa u kufizuar, edhe përmes:

- intervistave me stafin institucional;
- punëtorive me grupet punuese;
- anketave me punonjës, qytetarë apo biznese;
- konsultimeve me grupe relevante të interesit.

Qëllimi i këtyre konsultimeve është që të:

- identifikohen procese që perceptohen si të cenueshme ndaj korrupsionit;
- kuptohen praktikat jo formale apo presionet;
- mblidhen shembuj të situatave problematike; si dhe
- validohen gjetjet nga burime të tjera informacioni.

### **Përdorimi i informacionit të mbledhur**

Bazuar në informacionin e mbledhur nga pesë kategoritë e mësipërme, Agjencia dhe grupi punues do të:

- Identifikojnë proceset kryesore dhe pikat e vendimmarrjes brenda fushës apo sektorit;
- Zbulojnë fushat ku diskrecioni, vlera financiare apo kontrollet e dobëta krijojnë mundësi për korrupsion;
- Formulojnë skenarë konkretë të rrezikut të korrupsionit të lidhur me procese apo funksione specifike;
- Regjistrojnë rreziqet e identifikuara në regjistrin e rreziqeve sektoriale apo të fushës.

Identifikimi i rreziqeve do të mbështetet si në të dhëna sasiore dhe cilësore. Kur informacioni i siguruar nga burime të ndryshme jep indikacione për të njëjtën mangësi apo të njëjtin model/shabllon, çështja do të trajtohet si rrezik korrupsioni me prioritet më të lartë.

Kjo qasje e strukturuar siguron që identifikimi i rrezikut të bazohet në burime të shumta prove dhe që gjetjet të jenë të krahasueshme ndërmjet fushave apo sektorëve.

## 1.2.2 Identifikimi i rrezikut

Bazuar në dokumentet e mbledhura, identifikohen dy kategoritë e mëposhtme të informacionit në një dokument të veçantë - regjistrin e korrupsionit gjatë një procesi pune:

- Çdo lloj shkeljeje e lidhur me korrupsionin që kishte ndodhur në një fushë apo sektor në të kaluarën ose që teorikisht mund të ndodhte. Rastet apo incidentet e tilla grupohen sipas përmbajtjes dhe regjistrohet numri identifikues i tyre për sa i përket një skeme korrupsioni, së bashku me dëmet që kanë shkaktuar dhe procesin e reagimit ndaj tyre. Rreziqet specifike të korrupsionit burojnë pikërisht nga këto shkelje.
- Pasi shkeljet aktuale dhe të mundshme të lidhura me korrupsionin të përshkruara në paragrafin e mëparshëm të konstatohen si rreziqe korrupsioni, duhet të përcaktohen shkaqet për çdo rrezik individual. Shkaqet mund të lidhen me legjislacionin si dhe dobësitë e zbatimit të tij, nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të punonjësve, dobësinë e mekanizmave mbikëqyrës etj.

Pas kësaj, rreziqet e identifikuara të korrupsionit duhet të grupohen sipas kategorive për të thjeshtuar menaxhimin e tyre në të ardhmen. Për shembull:

- Konflikti i interesit;
- Marrja dhe dhënia e rryshfetit;
- Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar, etj.

Për çdo rrezik të identifikuar në këtë fazë, duhet të përcaktohet fushëveprimi i tij, me fjalë të tjera, kush mund të lidhet me rreziqe specifike: udhëheqja e institucionit, njësitë strukturore të brendshme të një institucioni ose persona juridikë në varësi të institucioneve.

Si shtojcë e kësaj Metodologjie është Aneksi 1 i cili jep shpjegime joshteruese në lidhje me identifikimin e rreziqeve.

## FAZA E TRETË

### 1.3 Vlerësimi i rrezikut dhe prioritizimi

Kjo fazë përfshin vlerësimin e rreziqeve të identifikuar të korrupsionit, identifikimin e mekanizmave ekzistues të kontrollit, prioritizimin e rreziqeve dhe krijimin e regjistrit të rreziqeve bazuar në informacionin e marrë gjatë fazave të mëparshme.

#### 1.3.1 Indikatorët për vlerësimin e rrezikut

Çdo rrezik i identifikuar do të vlerësohet bazuar në dy indikatorë:

- Probabiliteti – gjasat që ngjarja e rrezikut të ndodhë
- Ndikimi (pasoja) – shkalla e rezultatit negativ nëse shfaqet ngjarja e rrezikut.

Për të siguruar vlerësime të qëndrueshme dhe të krahasueshme ndërmjet fushave apo sektorëve, nivelet e probabilitetit dhe ndikimit interpretohen sipas udhëzimeve të përgjithshme në vijim.

#### Probabiliteti (gjasa për të ndodhur)

- **Probabilitet shumë i ulët:** Rreziku është pothuajse i pamundur të ndodhë për shkak të kornizës shumë të fortë ligjore dhe procedurale, kontrolleve të brendshme të avancuara dhe plotësisht funksionale, mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe efektive, transparencës së lartë institucionale, si dhe mungesës së plotë të ankesave, gjetjeve të auditimit, parregullsive apo rasteve të mëparshme të korrupsionit.
- **Probabilitet i ulët:** Rreziku ka pak gjasa të ndodhë për shkak të rregullave të qarta ligjore, kontrolleve të forta të brendshme, mbikëqyrjes efektive dhe mungesës së ankesave, gjetjeve të auditimit apo rasteve të mëparshme të korrupsionit.
- **Probabilitet i mesëm:** Rreziku mund të ndodhë për shkak të disa dobësive procedurale, kontrolleve jo të njëtrajtshme, ankesave të rastit apo incidenteve të izoluar të mëparshme.
- **Probabilitet i lartë:** Rreziku ka gjasa të ndodhë për shkak të diskrecionit të konsiderueshëm, kontrolleve të dobëta apo mungesës së tyre, ankesave të përsëritura, gjetjeve të auditimit apo rasteve të mëparshme të korrupsionit.

- **Probabilitet shumë i lartë:** Rreziku ka shumë gjasa të ndodhë për shkak të nivelit të lartë të diskrecionit, mungesës ose dobësisë serioze të kontroleve të brendshme, mbikëqyrjes jo efektive, ankesave të shpeshta dhe të përsëritura, gjetjeve të shumta të auditimit, si dhe ekzistencës së rasteve të mëparshme apo indikacioneve të vazhdueshme të korrupsionit.

### Ndikimi (ashpërsia e pasojave)

- **Ndikim shumë i ulët:** Rreziku do të kishte pasoja minimale dhe pothuajse të papërfillshme, duke shkaktuar vetëm devijime shumë të vogla procedurale pa ndikim në funksionimin normal të proceseve, pa dëme financiare ose me dëme krejtësisht të kufizuara, dhe pa ndikim në cilësinë e shërbimeve apo në besimin publik.
- **Ndikim i ulët:** Rreziku do të rezultonte në dëme financiare të kufizuara, parregullsi procedurale të vogla apo ndikim të papërfillshëm në ofrimin e shërbimeve apo besimin publik.
- **Ndikim i mesëm:** Rreziku do të rezultonte në humbje të dukshme financiare, ndërprerje të shërbimeve, trajtim të padrejtë të përfituesve apo dëmtim reputacional të institucionit.
- **Ndikim i madh:** Rreziku do të rezultonte në humbje të mëdha financiare, shtrembërim sistemik të vendimarrjes, dëm serioz ndaj interesit publik apo humbje të konsiderueshme të besimit publik.
- **Ndikim shumë i lartë:** Rreziku do të rezultonte në pasoja kritike, duke shkaktuar humbje të mëdha financiare, dështim të proceseve kyçe institucionale, shtrembërim sistemik të vendimarrjes dhe qeverisjes, cenim serioz të interesit publik, si dhe humbje të konsiderueshme të besimit publik me ndikim afatgjatë në funksionimin e institucionit.

## 1.3.2 Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit

Probabiliteti i secilit rrezik do të vlerësohet bazuar në një analizë të strukturuar, ndër të tjera në fushat në vijim:

Mjedisi ligjor dhe rregullator

- qartësia dhe konsistenca e dispozitave ligjore;
- niveli i diskrecionit të akorduar zyrtarëve;
- ekzistenca e garancive procedurale dhe afateve kohore.

#### Dizajni i procesit dhe kontrollet

- numri dhe kompleksiteti i pikave të vendimmarrjes;
- ekzistenca e listave kontrolluese, kontrolleve të automatizuara apo sistemeve digjitale;
- ndarja e detyrave dhe nivelet e miratimit.

#### Integriteti institucional dhe mbikëqyrja

- efektiviteti i kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes;
- niveli i mbikëqyrjes dhe mekanizmat e llogaridhënies;
- trajnimet dhe ndërgjegjësimi i stafit për etikën dhe integritetin;
- rastet apo incidentet dhe sinjalet e mëparshme;
- raste korrupsioni;
- masa disiplinore;
- ankesa, gjetje auditimi apo raporte të integritetit.

Grupi punues mund t'i marrë parasysh këto fusha në mënyrë të kombinuar gjatë përcaktimit të nivelit të probabilitetit për secilin rrezik.

### **Përdorimi i të dhënave dhe i gjykimit profesional**

Në vlerësimin e probabilitetit dhe ndikimit, grupi punues do të mbështetet në një kombinim të të dhënave të disponueshme dhe gjykimit profesional. Burimet relevante mund të përfshijnë:

- të dhëna statistikore;
- gjetje të auditimit dhe inspektimit;
- ankesa dhe raporte nga sinjalizuesit;
- raste të mëparshme korrupsioni;
- intervista, punëtoritë dhe anketa me palë të fushës apo sektorit.

Kur të dhënat statistikore janë të kufizuara apo mungojnë, vlerësimi do të bazohet në input cilësor nga aktorë relevantë dhe faktorë të dokumentuar të rrezikut.


Në raste të tilla, grupi punues mund të mbledhë input nga:

- përfaqësues të menaxhmentit;
- staf operacional të përfshirë në procese kyçe;
- auditorë të brendshëm apo zyrtarë të kontrollit, dhe
- palë të jashtme relevante, sipas rastit.

## Matrica e rrezikut dhe prioritizimi

Pas përcaktimit të niveleve të probabilitetit dhe ndikimit, secili rrezik do të klasifikohet duke përdorur një matricë të thjeshtë rreziku. Kombinimi i probabilitetit dhe ndikimit do të përcaktojë nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe prioritetin e tij për masa zbutëse.

Matrica e rrezikut (shih tabelën më poshtë) do të përdoret për të siguruar prioritizim të qëndrueshëm ndërmjet fushave apo sektorëve.



Matrica e rrezikut (tabela e vlerësimit të rrezikut) bazohet në kombinimin e dy elementeve kryesore: probabilitetit të ndodhjes dhe ndikimit që rreziku mund të ketë. Përmes shumëzimit të këtyre dy faktorëve, gjenerohet një indeks rreziku nga 1 deri në 25, i cili më pas klasifikohet në pesë (5) kategori kryesore të rrezikut. Këto kategori shërbejnë për të orientuar institucionin për nivelin e reagimit dhe masat që duhet të ndërmerren.

**Kategoria e parë** është rreziku shumë i ulët (1–5), i paraqitur me ngjyrë të gjelbër. Këto janë rreziqe me ndikim dhe probabilitet shumë të kufizuar, të cilat nuk paraqesin kërcënim potencial për funksionimin e institucionit. Menaxhimi i tyre kërkon vetëm monitorim të rastit dhe zbatimin e kontrolleve standarde ekzistuese, pa nevojë për ndërhyrje shtesë.

**Kategoria e dytë** është rreziku i ulët (6–10), i paraqitur me ngjyrë të verdhë. Këto janë rreziqe me ndikim dhe probabilitet të kufizuar, të cilat nuk paraqesin kërcënim të menjëhershëm për funksionimin e institucionit. Menaxhimi i tyre kërkon monitorim rutinë dhe zbatimin e kontrolleve standarde ekzistuese, pa nevojë për ndërhyrje shtesë.

**Kategoria e tretë** është rreziku mesatar (11–15), i paraqitur me ngjyrë portokalli. Këto rreziqe kërkojnë vëmendje më të madhe, pasi mund të ndikojnë në performancën e proceseve nëse nuk trajtohen me kohë. Në këtë rast, rekomandohet rishikimi i kontrolleve ekzistuese dhe ndërmarrja e masave përmirësuese për të reduktuar probabilitetin ose ndikimin.

**Kategoria e katërt është rreziku i lartë (16–20)**, i paraqitur me ngjyrë të kuqe. Këto rreziqe kanë potencial të konsiderueshëm për të ndikuar në objektivat e institucionit dhe kërkojnë masa konkrete zbutëse. Menaxhimi i tyre duhet të jetë aktiv, me monitorim të rregullt dhe përgjegjësi të qarta për zbatimin e veprimeve parandaluese.

**Kategoria e pestë** është rreziku kritik (21–25), i paraqitur me ngjyrë vjollcë. Kjo kategori përfshin rreziqet me probabilitet dhe/ose ndikim shumë të lartë, të cilat mund të cenojnë seriozisht funksionimin e institucionit ose arritjen e objektivave strategjike. Këto raste kërkojnë ndërhyrje prioritare dhe masa të menjëhershme, shpesh në nivel drejtues, për të minimizuar pasojat dhe për të rikthyer kontrollin mbi situatën.

Vlerësimi i rreziqeve në këtë tabelë mbështetet në gjykim profesional dhe objektiv, duke marrë parasysh kontekstin institucional dhe informacionin në dispozicion.

## FAZA E KATËRT

### 1.4 Përgatitja e raportit

Faza përfundimtare e procesit të VRRK-së është përgatitja e raportit të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit për fushën apo sektorin e përzgjedhur. Raporti do të paraqesë rezultatet e të gjithë procesit të VRRK-së dhe mund të shërbejë si dokument referues kryesor për zbatimin dhe monitorimin e masave kundër korrupsionit brenda fushës apo sektorit të vlerësuar.

Çdo raport i VRRK-së do të ndjekë një strukturë standarde dhe do të përfshijë, së paku, elementet në vijim:

#### **Përmbledhje e fushës apo sektorit**

Një përshkrim i shkurtër i fushës apo sektorit, organizatave publike të përfshira në vlerësim dhe funksioneve apo shërbimeve kryesore të analizuar.

#### **Metodologjia dhe procesi**

Një shpjegim i shkurtër i metodologjisë së zbatuar, fazave të VRRK-së, burimeve të informacionit të përdorura dhe përbërjes së grupit punues.

#### **Analiza e proceseve**

Një përmbledhje e proceseve kryesore dhe pikave të vendimmarrjes të shqyrtuara gjatë vlerësimit, me vëmendje të veçantë ndaj fushave që përfshijnë diskrecion, flukse financiare apo ndërveprim me qytetarë apo biznese.

#### **Rreziqet e identifikuara të korrupsionit**

Një paraqitje e strukturuar e rreziqeve kryesore të korrupsionit, përfshirë: përshkrimin e secilit skenar rreziku, shkaqet apo faktorët kryesor të rrezikut, njësitë institucionale apo grupet e interesit, etj.

## **Vlerësimi dhe prioritizimi i rrezikut**

Rezultatet e vlerësimit të probabilitetit dhe ndikimit, përfshirë nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe prioritizimin e rreziqeve.

## **Masat zbutëse**

Një grup masash konkrete që synojnë reduktimin e rreziqeve të identifikuar. Çdo masë do të:

- lidhet drejtpërdrejt me një rrezik specifik dhe shkaqet e tij;
- jetë praktike dhe operative
- jetë proporcionale me nivelin e rrezikut;
- përcaktojë institucionin apo njësinë përgjegjëse; dhe
- përfshijë një afat indikativ zbatimi.

Versioni përfundimtar i regjistrit të rreziqeve do t'i bashkëngjitet raportit si aneks kryesor. Regjistri i rreziqeve do ta ndjekë një format standard dhe do të përfshijë, së paku:

- listën e rreziqeve të identifikuar;
- shkaqet apo faktorët kryesor të rrezikut;
- nivelet e vlerësuara të probabilitetit dhe ndikimit;
- nivelin e përgjithshëm apo prioritetin e rrezikut;
- masat e rekomanduara zbutëse;
- aktorët përgjegjës; dhe
- afatet e propozuara.

Para finalizimit, draft-raporti i VRRK-së do t'u çarkullohet organizatave publike pjesëmarrëse për komente. Pas shqyrtimit të komenteve, Agjencia do të miratojë raportin përfundimtar dhe ia dërgon të njëjtin organizatave publike të përfshira dhe mund ta publikojë atë. Agjencia e informon edhe organin që mbikëqyr punën e atyre autoriteteve.

Raporti i miratuar nga Drejtori i Agjencisë, mund të shërbejë si dokument referues për hartimin e Planit të Veprimit të zbatimit dhe monitorimit të masave të rekomanduara brenda fushës apo sektorit të vlerësuar.

Mbledhja e informacionit për secilën fazë mund të bëhet në formë elektronike, kur kjo është e mundur. Në rastet kur kjo nuk është e mundur, procesi realizohet në mënyrë manuale, përmes komunikimit me e-mail dhe formave të tjera zyrtare të komunikimit.

# Aneksi 1

## SHEMBULL ILUSTRUES – PROCESI I LICENCIMIT

Ky aneks është përparitur vetëm për qëllime ilustrimi dhe udhëzimi praktik. Shembulli i paraqitur më poshtë nuk përfaqëson një vlerësim real të një fushe, sektori apo institucioni të caktuar dhe nuk duhet të kuptohet si model i detyrueshëm apo shterues. Qëllimi i tij është të tregojë, në mënyrë të thjeshtuar, se si mund të zbatohet metodologjia në praktikë, duke filluar nga mbledhja e informacionit, hartëzimi i procesit, identifikimi i skenarëve të rrezikut, faktorëve të rrezikut dhe deri te përparitja e regjistrimit të rreziqeve.

Në zbatimin praktik të VRRK-së, hapat, burimet e informacionit, skenarët e rrezikut dhe kategoritë e rrezikut duhet të përshatën me natyrën e fushës apo sektorit që vlerësohet, mandatin e institucioneve përkatëse, të dhënat në dispozicion dhe kontekstin konkret institucional. Për këtë arsye, shembulli duhet të përdoret vetëm si orientim metodologjik dhe jo si zëvendësim për analizën faktike të secilit rast konkret.

### HAPI 1 Informacioni i mbledhur (Seksioni 1.2.1)

KATEGORIA E BURIMIT	BURIMI	GJETJA KRYESORE
KORNIZA NORMATIVE	Analiza ligjore	Ligji lejon diskrecion të gjerë në aprovimin e licencave; nuk ka afate të qarta për vendimmarrje.
	Rregullorja e brendshme	Nuk ekziston listë kontrolluese e standardizuar për verifikimin e dokumenteve.
	Shqyrtimi i PSO	Departamente të ndryshme aplikojnë procedura të ndryshme për të njëjtin lloj licence.
	Udhëzimet operative	Disa hapa trajtohen në mënyrë informale pa evidencë të shkruar.

KATEGORIA E BURIMIT	BURIMI	GJETJA KRYESORE
<b>GJETJET E KONTROLLIT</b>	Raport i auditimit të jashtëm	Vonesa të përsëritura në procesimin e licencave; mungesë arsytimi për refuzime.
	Auditimi i brendshëm	Pranohen dhe procedohen dosje aplikimi të pakompletuara.
	Raport inspektimi	Aplikim jo i njëtrajtshëm i kritereve teknike ndërmjet rajoneve.
<b>TË DHËNAT OPERATIVE</b>	Statistika sektoriale apo të fushës	Përqindje e lartë e aplikimeve të refuzuara pa shpjegim të detajuar.
	Treguesit e performancës	Koha mesatare e procesimit tejkalon standardet ligjore për 40%.
	Regjistrat e ankesave	Ankesa të shumta për vonesa dhe kërkesa për pagesa informale.
	Linja telefonike rreth integritetit	Dy raportime anonime për zyrtarë që kërkojnë pagesa.
<b>RASTE APO INCIDENTE FAKTIKE</b>	Lëndët penale	Dy raste ryshfeti që përfshijnë zyrtarë të licencimit.
	Masa disiplinore	Një zyrtar i sanksionuar për manipulim të dosjeve.
	Sanksione administrative	Një licencë e revokuar për shkak të dokumentacionit të rremë të pranuar nga stafi.
<b>PERCEPTIMET DHE PERVOJA PRAKTIKE</b>	Intervista me staf	Zyrtarët raportojnë presion për të përshpejtuar aplikime të caktuara.
	Anketë me biznese	Miratimet raportohen të jenë më të shpejta përmes ndërmjetësve.
	Punëtori me palë të interesit	Verifikimi i dokumenteve identifikohet si faza më e cenueshme.

**HAPI 2 Hartëzimi i procesit kyç dhe pikave të vendimmarrjes**

HAPI I PROCESIT	NJËSIA PËRGJEGJËSE	PIKA KYÇE E VENDIMMARRJES	NIVELI I DISKRECIONIT
Dorëzimi i aplikimit	Zyra pritëse	Pranimi ose refuzimi i aplikimit	I mesëm
Verifikimi i dokumenteve	Njësia e licencimit	Përcaktimi i validitetit dhe nëse është i kompletuar	I lartë
Vlerësimi teknik	Komisioni institucional	Vlerësimi i përputhshmërisë me kriteret	I lartë
Aprovimi përfundimtar	Shefi i departamentit	Dhënia ose refuzimi i licencës	I lartë
Lëshimi i licencës	Administrata	Dhënia formale dhe regjistrimi	I ulët

**HAPI 3 Identifikimi i skenarëve të rrezikut të korrupsionit**

HAPI I PROCESIT	SKENARI I RREZIKUT	PËRSHKRIMI
Pranimi i aplikimit	Pranimi i aplikimit pa dokumentacion të plotë	Në disa raste aplikimi mund të pranohet edhe kur dokumentacioni nuk është plotësisht i kompletuar, duke krijuar hapësirë për trajtim jo të njëjtë të aplikantëve.
Verifikimi i dokumenteve	Zvarritje në procesin e verifikimit	Procesi i verifikimit mund të zgjasë më shumë sesa afatet e zakonshme, për shkak të ngarkesës administrative ose mungesës së standardizimit të procedurës.
Vlerësimi teknik	Interpretim i ndryshëm i kriterëve	Gjatë vlerësimit teknik mund të ketë interpretim jo të njëjtë të kriterëve ose kërkesave teknike nga ana e stafit përgjegjës.
Aprovimi përfundimtar	Ndikim në procesin vendimmarrës	Vendimi përfundimtar mund të ndikohet nga faktorë të ndryshëm institucionalë ose administrativë që nuk janë plotësisht të dokumentuar në dosje.
Lëshimi i licencës	Dallime në kohëzgjatjen e procesimit	Koha e lëshimit të licencave mund të ndryshojë ndërmjet aplikantëve për shkak të prioritizimeve operative ose faktorëve të tjerë proceduralë.

**HAPI 4 Identifikimi i faktorëve kryesorë të rrezikut**

SKENARI I RREZIKUT	FAKTORËT KRYESOR TË RREZIKUT
Pranimi i dosjeve të pa-kompletuara	Mungesë e listës së kontrollit; mbikëqyrje e dobët; diskrecion i lartë
Vonesa për të kërkuar ryshfet	Mungesë e afateve ligjore; varet nga aplikanti
Vlerësime të manipuluar	Kritere të paqarta; mungesë e rishikimit kolegial
Vendime të ndikuara	Përqendrim i autoritetit; mbikëqyrje e dobët
Lëshim preferencial	Mungesë e monitorimit të kohës së procesimit; transparencë e ulët

**HAPI 5 Regjistri i rreziqeve**

PROCESI	SKENARI I RREZIKUT	FAKTORËT E RREZIKUT	AKTORËT E PËRFSHIRË	KATEGORIA E RREZIKUT
Pranimi i aplikimit	Pranimi i aplikimit të pakompletuar për pagesë	Mungesë e listës së kontrollit; kontrolle të dobëta	Stafi i zyrës pritëse	Ryshfeti
Verifikimi i dokumenteve	Vonesë për të kërkuar pagesë	Mungesë afatesh; diskrecion i lartë	Zyrtarët e licencimit	Ryshfet / shpërdorim i detyrës
Vlerësimi teknik	Miratim pavarësisht mospërputhjes	Kritere të dobëta; mungesë mbikëqyrjeje	Komisioni teknik	Shpërdorim i detyrës
Aprovimi përfundimtar	Vendim i ndikuar nga aktorë të jashtëm	Autoritet i përqendruar; kontrolle të dobëta	Shefi i departamentit	Konflikt interesi / shpërdorim
Lëshimi i licencës	Procesim preferencial	Mungesë monitorimi; mungesë transparence	Stafi administrativ	Favorizim

**HAPI 6** Grupimi i rreziqeve sipas kategorisë**KATEGORIA E RREZIKUT****RREZIQE TË NDËRLIDHURA**

Ryshfeti

Pranim i dosjeve të paplota; vonesa për pagesë

Shpërdorim i detyrës

Vlerësime të manipuluar; aprovimet nën ndikim

Konflikti i interesit

Vendime të ndikuara nga lidhje personale apo politike

Favorizim

Procesim preferencial i aplikantëve të përzgjedhur





